



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1130 / Prot.  
13

Tiranë, më 21/12/2016

REKOMANDIM

Nr. 35, datë 21/12/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Albtours D - Vas Tour Operatore" Sh.p.k. Tiranë.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 227, datë 21.10.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Albtours D - Vas Tour Operatore" Sh.p.k (Nipt J62001503J), me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Kontrolluesi "Albtours D – Vas Tour Operatore" Sh.p.k është operator turistik që ushtron aktivitetin në fushën e ofrimit, gjetjes dhe mundësimit të udhëtimeve turistike, biletave të udhëtimit në mënyra të ndryshme transporti. Gjatë ofrimit të shërbimeve përpunon të dhëna personale kryesisht për kategorinë e subjekteve të të dhënave "klientë".

1. Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave "Klientë" dhe "Punëmarrës". Për kategorinë "klientë" kontrolluesi përpunon; të dhënat e identifikimit, nr. pasaporte, nr. telefoni, adresa, e-mail. Për kategorinë "punëmarrës", kontrolluesi përpunon të dhëna të identifikimit, jetën profesionale, nr. e sigurimit shoqëror, nëpërmjet administrimit të dokumenteve në dosjen e punës për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore. Gjithashtu, kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave, nëpërmjet mbikëqyrjes së ambienteve me kamera vëzhgim regjistrimi CCTV.

Kontrolluesi realizon marketing përmes postës elektronike, duke dërguar periodikisht email-e me ofertat e fundit në adresat e klientëve të tij. Kontrolluesi ka krijuar lista me adresa email të subjekteve të të dhënave që regjistrohen në "Newsletter" në faqen [www.vas.al](http://www.vas.al), ose hapin një llogari në këtë faqe (klientët e përhershëm). Çdo klient ka mundësinë të çregjistrohet nga ky shërbim.

Nga verifikimi i kryer u konstatua se nuk është përcaktuar një afat për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale të klientëve, në kundërshtim me nenin 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar. Zyra e Komisionerit vlerëson se të dhënat personale të klientëve duhet të mbahen për aq kohë sa ekziston qëllimi i përpunimit që në këtë rast është ofrimi i biletave të udhëtimit, gjetjes dhe mundësisimit të udhëtimeve turistike dhe mënyrave të ndryshme të transportit.

Në faqen online [www.vas.al](http://www.vas.al), në rubrikën “Mbrojtja e të Dhënave”, rezultoi se kontrolluesi ka publikuar informacione lidhur me “Politikat e privatësisë”, por nga verifikimi i kryer në këtë rubrikë nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Opinionin e Komisionerit “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat”.

2. Nëpërmjet sistemit të video-surveimit kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave “Klientë” dhe “Punëmarrës”. Kontrolluesi ka në administrim 12 kamera të vendosura në ambientet ku ushtron aktivitetin, këto të dhëna ruhen për një afat 15 (pesëmbëdhjetë) ditor me qëllim garantimin e sigurisë. Regjistrimet ruhen në pajisjen DVR, të vendosur në ambientin e serverëve, ku aksesimi është gjithmonë i kufizuar dhe aksesohen vetëm nga përgjegjësi IT i përcaktuar nga administratori.

Në lidhje me këtë përpunim u konstatua se kontrolluesi nuk realizon informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të surveimit në hyrje të ambienteve ku ushtron veprimtarinë e tij, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar dhe me Udhëzimin e Komisionerit nr. 3, datë 05/03/2010 *“Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*, i ndryshuar.

3. Në kuadër të zbatimit të detyrimit për njoftim, nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, u konstatua se kontrolluesi “Albtours D – Vas Tour Operatore” Sh.p.k, e kishte realizuar detyrimin për njoftim. Nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit rezultoi se kontrolluesi nuk e kishte kryer përditësimin për ndryshim të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket rubrikës 4.1 të formularit të njoftimit *“Kategoritë e të dhënave personale”*, lidhur me të dhënat mbi: adresë, nr. telefoni dhe e-mail; si dhe në nënrubrikën 1.2 të dhënat e personit të kontaktit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për njoftim dhe përditësimi i “Formularit të Njoftimit” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

4. Kontrolluesi nuk ka hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar;

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave

personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektsh të të dhënave).

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", u caktua ora 10:30 e datës 15/12/2016 për zhvillimin e seancës dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Përfaqësuesit e kontrolluesit "*Albtours D – Vas Tour Operatore*" Sh.p.k, gjatë seancës dëgjimore, kanë dokumentuar masat e marra në kuadër të konstatimeve të grupit të kontrollit, si:

- Rregullorja e brendshme për Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale (në zbatim të nenit 27 të ligjit);
- Informacioni publikuar në rubrikën "Mbrojtja e të Dhënave" në faqen online të kontrolluesit lidhur me "Politikat e privatësisë";
- Foto të tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të survejimit të vendosur në hyrje të ambienteve ku ushtron veprimtarinë e tij.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit, i cili ka qenë i ndërsjellët në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neni 31, pika 1, germa a/1,

### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "**Albtours D – Vas Tour Operatore**" Sh.p.k, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar:
  - Të marrë masa për të përfshirë në faqen e tij të Internetit në rubrikën "Politikat e Privatësisë" informacionin sipas Opinionit të Komisionerit "Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat";
  - Të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese për sistemin e video-vëzhgimit, sipas modelit standard të tabelës informuese të përcaktuar në Udhëzimin nr. 3 datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*", i ndryshuar.
2. Në zbatim të nenit 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të dhënat personale të klientëve të mbahen për aq kohë sa ekziston qëllimi i përpunimit duke përcaktuar afatin e mbajtjes së tyre.
3. Kontrolluesi "**Albtours D – Vas Tour Operatore**" Sh.p.k, në zbatim të nenit 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.

4. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të respektohen në vazhdimësi masat teknike dhe organizative të sanksionuara në “Rregulloren e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale”, të miratuar nga kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave të klientëve;
5. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 15 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit;
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky rekomandim u shpall sot më datë 21.12 2016.

